



# DITARI MUJOR

## PRILL 2024

### Infrastruktura shkollore, hapen 40 kantiere të reja

Vijon puna me ritëm të lartë për rehabilitimin e infrastrukturës shkollore dhe terreneve sportive, teksa hapen 40 kantiere të reja në të gjithë vendin. Së bashku me kryeministrin Edi Rama, ministrja Ogerta Manastirliu mori pjesë në përirimin e shkollës së re "Demokracia" në Valiasin e ri, në Kamëz. Në qarkun e Fierit, së bashku me shkollën 9-vjeçare "Naim Frashëri", po rehabilitohen edhe 6 objekte të tjera arsimore që do t'u shërbejnë mbi 2 mijë nxënësve dhe mësuesve. Ndërsa në Shkodër nisnin investimet në pesë shkolla të qytetit.

### Vlora dhe Shkodra firmosin për Kartën e Studentit

Përmbillet cikli i nënshkrimit të marrëveshjeve me pushtetin vendor për Kartën e Studentit. Ministrja e Arsimit dhe Sportit, Ogerta Manastirliu nënshkroi marrëveshjet me kryetarin e Bashkisë së Shkodrës Benet Beci për të lehtësuar jetën akademike të studentëve të universitetit "Luigj Gurakuqi" dhe me kryetarin e Bashkisë së Vlorës Ermal Dredha për të siguruar shërbime falas ose me çmime të reduktuara për studentët e universitetit "Ismail Qemali". Bashkë me Shkodrën dhe Vlorën shkon në 8 numri i bashkive që angazhohen të ndihmojnë studentët.

### Thjeshtohen procedurat e punësimit për mësuesit

Thjeshtohen procedurat e punësimit të mësuesve. Për herë të parë, testimi për licensim dhe aplikimi në portalin "Mësues për Shqipërinë" mund të bëhen në të njëjtën ditë, duke shkurtuar me 6 muaj kohën e pritjes për punësimin e mësuesve. Ky ndryshim do të ndihmojë mijëra mësues të rinj që të integrohen më lehtë në sistemin arsimor.

### Programi Kombëtar i Zhvillimit Profesional, janë trajnuar 2700 mësues

2700 mësues janë trajnuar deri më tani në të gjithë vendin si pjesë e Programit Kombëtar të Zhvillimit Profesional të Mësuesve. Ky program fokusohet në lëndët e gjuhës shqipe, matematikës, lëndët e shkencave, arsimit fillor dhe teknologji-informacioni, të cilat janë edhe lëndët që testohen nga PISA. Për herë të parë është lidhur një partneritet me universitetet në të gjithë vendin dhe janë 135 trajnuar nga stafet akademike universitare që po zhvillojnë këto trajnime.

## Hapet Kolegji European në Tiranë, Kuvendi ratifikon marrëveshjen

Një ngjarje historike për arsimin e lartë në Shqipëri! Kuvendi i hap rrugën ngritjes së Kolegjit të Europës në Tiranë, përmes ratifikimit të marrëveshjes që parashikon ngritjen e degës së tretë të këtij institucioni prestigjioz. Aktiviteti i këtij kolegji do të nisë me vitin akademik 2024-2025 me një program studimi pasuniversitar me temë: "Transformimi dhe Integrimi European: Bashkimi European dhe Europa Juglindore". Ky vit i parë do të nisë me 31 studentë dhe të vijojë në vitin e dytë me 50, duke synuar zgjerimin në vitet në vijim. Fillimisht ky Kolegj do të nisë aktivitetin në godinën "Liria" pranë Qytetit Studenti, ndërkohë që do të investohet për ngritjen e kampusit të ri. Marrëveshja parashikon mbështetjen me bursa nga buxheti i shtetit për 5 studentë shqiptarë, në shumën 27 000 euro për vit akademik



## Universiteti Bujqësor nis reformimin, nënshkruhet marrëveshja me Vienën



Ekselenca universitare austriake vjen në Shqipëri. Universiteti Bujqësor i Tiranës nis një proces 4-vjeçar reformimi, sipas standardeve të Universitetit prestigjioz të Burimeve Natyrore dhe Shkencave të Jetës (BOKU) të Vienës, një ndër institucionet më të mira në Europë, me një histori sukseesi mbi 150-vjeçare. Ky proces u parapri nga nënshkrimi i një memorandumi bashkëpunimi mes Ministrive të Arsimit dhe asaj të Bujqësisë të Shqipërisë dhe Austrisë për reformimin e tri cikleve të studimit dhe njësive të kërkimit shkencor të Universitetit Bujqësor të Tiranës, transferimin e njohurive dhe teknologjive, rritjen e kapaciteteve të stafit akademik, shkëmbimin e stafeve dhe studentëve, si dhe modernizimin e menaxhimit të UBT. Kjo marrëveshje e ngre në një nivel më të lartë procesin e ndërkombëtarizimit të universiteteve tona dhe u hap udhën e mëtejshme bashkëpunimit me institucionet ndërkombëtare.

### KONKURSI KOMBËTAR I GJUHËS SHQIPE, PËRMBYLLET FAZA GJYSMËFINALE

U zhvillua faza gjysmëfinale e Konkursit Kombëtar të Gjuhës Shqipe. Konkursi është pjesë e veprimtarive të zhvilluara në kuadrin e Vitit të Gjuhës Shqipe, që synon të sensibilizojë të rinjtë shqiptarë, por edhe institucionet mbi rëndësinë e kultivimit dhe trashëgimit të gjuhës shqipe. Kjo ngjarje bëri bashkë 11,000 nxënës nga 930 shkolla të ndryshme në të gjithë Shqipërinë. Pas dy fazave në nivel shkolle dhe në nivel qarku, përgjatë një jave u zhvillua përballja mes 16 shkollave gjysmëfinale, e cila u transmetuar direkt në kanalet RTSH 1 dhe RTSH Shkollë dhe në rrjetet sociale, nga 22-29 prill.



### PROJEKTI, KAMPUSI I "DYRRAH CITY FOOTBALL ACADEMY" ME 8 FUSHA SPORTI

Prezantohet projekti për kampusin e "Dyrrah City Football Academy", fryt i përpjekjeve të përbashkëta të qeverisë shqiptare dhe Manchester City & City Group. Një projekt që mban firmën e arkitektit të njohur italian Marco Casamonti, për ngritjen e qendrës më të madhe dhe më moderne stërvitore në vendin tonë, por edhe në rajon, me tetë fusha sportive, palestra, qendra fizioterapie e ambiente multifunksionale, ku do të zbulohen, formohen dhe promovohen talentet e reja. Tashmë është hartuar programi i kësaj akademie, i cili do të aplikohet nga ekspertët më të mirë të Manchester City.